

**AKT - THEMELIMI I SHOQERISE TREGTARE  
"Mevlani" SH.P.K.**

**Neni 1- FORMIMI**

Themelohet Shoqeria Tregtare me pergjegjesi te kufizuar me emertimin "Mevlani" Sh.p.k me Ortake te vetme znj. Armina Mevlani.

**Neni 2 - SELIA**

Shoqeria Tregtare "Mevlani" Sh.p.k. e ka seline ne: Tirane, Njesia bashkiake nr. 5, Rruga Brigada e VIII, Pallati nr.8, Shkalla nr.3, Kati 1.

**Neni 3 - KOHEZGJATJA**

Shoqeria Tregtare "Mevlani" Sh.p.k. ka nje kohezgjatje te veprimtarise se saj ekonomike te pakufizuar.

**Neni 4 - OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

Objekti i veprimtarise ekonomike i Shoqerise Tregtare "Mevlani" Sh.p.k. eshte:

- dizenjim / modelim i veshjeve dhe aksesoreve te tyre ne fushen e fashion / modes;
- krijimi i markes (brand);
- tregtimi i veshjeve dhe aksesoreve te tyre te prodhuara sipas dizenjimit / markes se shoqerise;
- import / eksport i veshjeve dhe aksesoreve te tyre;
- aktivite te tjera te lidhura ose plotesuese te sa me siper.

**Neni 5 - KAPITALI I SHOQERISE**

Kapitali themeltar i Shoqerise Tregtare "Mevlani" Sh.p.k eshte 100 Lekë (njqind), i cili do te shlyhet i gjithi nga Ortakja e vetme e shoqerise. Kapitali perbehet nga 1 kuote.

**Neni 6**

Shoqeria Tregtare "Mevlani" Sh.p.k. ka si Administrator te saj znj. Armina Mevlani, shtetase shqiptare, lindur me 06.06.1991, ne Tirane dhe banuese ne Tirane, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtëse e dokumentit te identifikimit me nr. personal J15606086L, e cila do te ushtroje te gjitha kompetencat e administrimit te zakonshem dhe te jashtezakonshem te shoqerise, per nje afat 5 vjecar.

Administratori mund te jape doreheqjen ose te revokohet nga shumica e ortakeve ne cdo moment.

**Neni 7- SHPERBERJA E SHOQERISE**

Shperberja e Shoqerise Tregtare "Mevlani" Sh.p.k. mund te vije ne cdo kohe dhe per cfaredolloj shkak, duke vepruar sipas kritereve te parashikuara ne Statutin e Shoqerise.

**ORTAKE E VETME E SHOQERISE TREGTARE  
"Mevlani" Sh.p.k**



## STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "Mevlani" SH.P.K

Sot, me 23/2/2022 (dymije e njezet e dy), ne perputhje me kerkesat e Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar, Ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", i ndryshuar, ortakja e vetme e shoqerise, ka vendosur themelimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar me emrin "Mevlani" shpk.

Ortake e vetme e shoqerise eshte

znj. Armina Mevlani, shtetase shqiptare, lindur me 06.06.1991, ne Tirane dhe banuese ne Tirane, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtëse e dokumentit te identifikimit me nr. personal J15606086L

### **Neni 1: Objekti i veprimtarise**

Shoqeria ka per objekt veprimtarite e meposhtme:

- dizenjim / modelim i veshjeve dhe aksesoreve te tyre ne fushen e fashion / modes;
- krijimi i markes (brand);
- tregtimi i veshjeve dhe aksesoreve te tyre te prodhuara sipas dizenjimit / markes se shoqerise;
- import / eksport i veshjeve dhe aksesoreve te tyre;
- aktivitete te tjera te lidhura ose plotesuese te sa me siper.

### **Neni 2: Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e Shoqerise Tregtare "Mevlani" sh.p.k fillon me regjistrimin e saj ne Qendrën kombëtare te regjistrimit dhe do te vazhdoje per nje periudhe te pakufizuar.

### **Neni 3: Selia, hapësira në internet dhe adresa elektronike**

1. Shoqëria e ka selinë ligjore te regjistruar në adresën: Tirane, Njesia bashkiake nr. 5, Rruga Brigada e VIII, Pallati nr.8, Shkalla nr.3, Kati 1

2. Shoqëria mund të zhvillojë veprimtarinë e saj ekonomike në të gjithë territorin e Shqipërisë si edhe jashtë saj duke hapur degë dhe/ose zyra përfaqësimi, filiale, agjenci etj. në qendra të tjera administrative në përputhje me legjislacionin e vendeve në të cilat ato hapen.

## KAPITULLI II Kapitali dhe kuotat

### **Neni 4: Shumat dhe pagesat e kapitalit themeltar**

Kapitali i shoqërisë është 100 Lekë (njqind). Kapitali i shoqërisë eshte i perbere nga 1 kuote e zotëruar nga ortakja e vetme e saj si ne vijim:

**Znj. Armina Mevlani** zoteron 1 kuote, te barabarte me 100% te pjesemarrjes ne kapitalin e shoqerise, te barabarte me 100 leke;

### **Neni 5: Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit**

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

(4) Nëse Asambleja nuk pranon të regjistrohet kalimi i kuotës, administratorët/i brënda një muaji pas datës në të cilën është bërë kërkesa për regjistrimin e kalimit në shoqëri, i dërgojnë blerësit njoftimin për mospranimin.

### KREU III ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

#### **Neni 8: Organi Vendimmarres**

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

#### **Neni 9: Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t’u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

#### **Neni 10: Kuorumi**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.



- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Ne pergjithesi administratori i shoqerise do te kete te drejte dhe kompetence te realizoje te gjitha veprimet per administrimin e zakonshem dhe te jashtezakonshem te shoqerise.

Administratoret janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Pergjitheshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 2 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 2 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

### **Neni 15: Përgjegjësia e Administratorit**

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- e) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “Shoqeri ne likuidim e siper”.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

### **Neni 19: Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

### **Neni 20: Baza Ligjore**

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqërite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik ne Republiken e Shqiperise.

### **Neni 21: Mosmarrëveshjet**

Per mosmarrëveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarrëveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptar.

## **ORTAKE E VETME E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“Mevlani” shpk**

**Armina Mevlani**

